



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
 Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve



Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tirane 26.04.2013

**Relacion**

*Mbi perditesimin e tarifave te prodhimit te energjise elektrike, furnizimit me shumice, transmetimit, shperndarjes se enrgjise elktrike si dhe percaktimin e cmitkimeve te KESH sh.a., TEC Vlore sh.a, OST sh.a., CEZ Shperndarje sh.a., Ulez-Shkopet sh.a., Bistrica1,2 sh.a*

**Bordit te Komisionereve**

Enti Rregullator i Energjise, ne zbatim te neneve 8, 9 dhe 26 te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Per sektorin e energjise elektrike“, te ndryshuar, dhe neneve 18, 20 dhe 21 te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE, miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve nr. 21 date 18.03.2009, i ndryshuar, me Vendimin nr. 161 date 07.12.2012, vendosi:

Të lërë në fuqi tarifat e miratuara nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 144, date 07.12.2012 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a, për Periudhën e Tretë Rregullatore”, vendimin nr. 87, date 29.06.2012, “Për rishikimin e tarifës për Furnizuesin Publik me Shumicë për Periudhën e Tretë Rregullatore për akomodimin e fekteve financiare të vendimit nr. 80 datë 15.06.2012 të Bordit të Komisionereve të ERE-s”, vendimin nr. 151, date 7.12.2011 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga TEC Vlora sh.a tek FPSH, për Periudhen e Trete Rregullatore”, vendimin nr. 152, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga HEC Bistrica

1,2 sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”, vendimin nr. 153, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Lanabregas sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”, vendimin nr. 154, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Ulez Shkopet sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”, vendimin nr. 146, date 7.12.2012 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për Periudhën e Trete Rregullatore”, vendimeve nr.147, date 07.12.2011 “Per percaktimin e tarifës së shperndarjes të energjisë elektrike për periudhën e trete rregullatore 2012-2014, vendimin nr.148 date 07.12.2011 “Per percaktimin e cmimeve të shitjes me pakice të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e trete rregullatore”, vendimi nr.149 date 07.12.2012 “Per percaktimin e cmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për vitin 2012”, vendimi nr. 150 date 07.12.2012 “Per percaktimin e cmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet egzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2012.

Ne këtë vendim u percaktua që Bordi i Komisionerëve të EREs do të perditesonte vendimet e parashtrura me sipër brenda datës 30 Qershor 2013.

Arsyet kryesore të marrjes së këtij vendimi ishin:

- 1- Shoqëritë paraqiten të dhëna dukshëm të ndryshme dhe me shumë vonese duke penguar qartësimin e treguesve bazë për perditesimin e tarifës sipas metodologjive perkatese.
- 2- ERE kishte nisur procedurat e heqjes së licencave për kompaninë CEZ Shperndarje, për mospërmbushjen e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi, detyrime të cilat ndikojnë tek treguesit e performancës dhe në mënyrë të veçantë tek humbjet dhe arketimet. Kjo situatë e vështiresoi dhe me tepër vendimmarrjen e ERE-s në lidhje me tarifën e energjisë për vazhdimësinë e kësaj kompanie në vitet që vijnë sipas treguesve perkatese.

Ky vendim reflektonte situatën në sektorin e energjisë elektrike në atë kohë, çka nënkuptonte paqartësi në treguesit teknik, ekonomik dhe financiar për të tre operatorët kryesor në kushtet e

veshtiresive te medha financiare te krijuara nga operatori i shpërndarjes, dhe qe konsistojn kryesisht ne pasaktesine e te dhenave; se pari mbi shitjet e energjise elektrike nga FPP te konsumatorit tarifore e cila nga ana e saj ben te paqarte burimin e sigurimit te kësaj energjie nga FPSH-ja dhe ne te njejten kohe kjo do te shoqerohej me nje pasaktesi te konsiderueshme ne percaktimin e te ardhurave te kerkuara per sektorin e enegjise elektrike.

Meqenese ky vendim i shtrin efektet deri **ne 30 qershor** 2013, nga Drejtorite Teknike u studiuin raportimet periodike dhe cdo e dhene e administruar ne ERE nga Operatoret ne treg.

Ne lidhje me treguesit tekniko-ekonomike e financiare te vitit 2012 si dhe parashikimi i treguesve te vitit 2013 qe sherbejne si baze per llogaritjen e te ardhurave te kerkuara per perditesimin e tarifes se prodhimit, transmetimit shperndarjes dhe furnizimit te energjise elektrike tek konsumatorit tarifore si dhe duke u nisur nga problematika qe perballon sot tregu i eneregjise elektrike, kemi patur nje korrespondence te gjere dhe intensive me kompanite, nepermjet te ciles eshte kerkuar paraqitja e shpjegimeve, te dhenave, informacioneve dhe dokumentave plotesuese lidhur me perditesimin e aplikimeve sipas te dhenave reale.

Grupi i punes pasi analizoi informacionin e derguar nga kompanite ka bere gjithsesi vleresime te te ardhurave te kerkuara per aktivitetin e prodhimit publik, furnizimit publik me shumice, transmetimit, shperndarjes dhe furnizimit publik me pakice per konsumatorit tarifore. Keto vleresime kane marre ne konsiderate skenare te ndryshem te situates hidrologjike te situates aktuale dhe ndodhive te fundit ne tregun e energjise elektrike ne Shqiperi, por edhe kushteve te tjera qe kane ndikim te drejte per drejte ne percaktimin e te ardhurave te mjaftueshme per nje operim normal te ketyre operatoreve ne permbushje te detyrimit te sigurimit te furnizimit me energji elektrike ne vend.

Gjate analizes se informacioneve ne lidhje me perditesimin e te ardhurave te kerkuara per operatoret e licensuar te tregut te energjise elektrike u identifikuan problematikat si me poshte :

- Zbatimi i kushteve te vendosura ne Deklaraten Rregullatore ne lidhje me parashikimin e gjenerimit publik sipas ketij akti si edhe vleresimin aktual te kushteve te favorshme

hidrologjike per vitin 2012-2014 perfshi destinacionin perkates te perdorimit (tregtimit) te sasise energjise elektrike pertej sasise te parashikuar ne Deklaraten Rregullatore.

- Statusi dhe Marredhenia perkatese e KESH sh.a me subjektet HEC Bistrica 1 dhe 2 sh.a dhe Hec Ulez Shkopet sh.a aktualisht paraqet paqartesi nderkohe qe sasia e energjise elektrike e prodhuar nga keto HEC-e eshte e konsiderushme. Me VKM nr. 26, date 9/1/2013 "Per miratimin e raportit perfundimtar te vleresimit te ofertave dhe te kandidatit fitues per privatizimin e shoqerise "HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a" dhe VKM nr.27, date 09/01/2013 "Per miratimin e raportit perfundimtare te vleresimit te ofertave dhe te kandidatit fitues per privatizimin e shoqerise " HEC Ulez-SHKopet" sh.a.", Keshilli i Ministrave ka miratuar ofertat e shoqerise "Kurum International" sh.a, si fitues per blerjen e 100% te aksioneve te shoqerive " HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. dhe "HEC Ulez Shkopet" sh.a. Po ashtu Kuvendi i Republikes se Shqiperise, me ligjin nr. 93/2013, date 4/3/2013 dhe ligjin nr.94/2013, date 4/3/2013, ka vendosur ratifikimin e kontrates per shitjen e 100% te aksioneve, perkatesisht te shoqerise "HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a. dhe shoqerise "HEC Ulez Shkopet" sh.a., te lidhur ndermjet Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes (si "Shitesi") dhe shoqerise "Kurum International" sh.a. (si "Bleresi").

Per arsyet e rradhitura me siper, deri ne përmbylljen e transaksionit te shitjes se aksioneve te ketyre HEC-eve dhe percaktimeve te tjera ne lidhje me destinacionin e shitjes se energjise elektrike te prodhura nga keto HEC-e tek Furnizuesi Publik me Shumice apo tek Klientet e Kualifikuar apo tregtaret, do te jene te panjohura burimet e sasise se energjise elektrike dhe çmimi qe duhet te siguroje FPSH-ja per përmbushjen e kontrates me FPP-ne. Ne te njejten kohe cdo llogaritje perfundimtare mund te çonte ne parashikime te pasakta te kostove shtese apo te ardhura te tepërta per kompanine.

- Mungesa e rakordimit te sasise se energjise elektrike te furnizuar nga KESH sh.a qe lidhet me përmbushjen e detyrimit te sasise se kontraktuar me FPP-ne per nevoja te klienteve tarfiore. U verejt gjithashtu edhe mungesa e rakordimit te sasise se energjise elektrike te furnizuar nga KESH sh.a pertej sasise qe lidhet me përmbushjen e detyrimit te sasise se

kontraktuar me FPP-ne per nevoja te klienteve tarfiore. Thuajse gjate gjithë vitit 2012 dhe po ashtu edhe gjate vitit 2011, u verejt se faturat tatimore te leshuara nga Kesh sh.a ndaj CEZ Shperndarje per sasine e energjise elektrike qe i korrespondon humbjeve ne sistemin e shperndarjes, te cilat perbenin detyrim prokurimi nga CEZ Shperndarje sh.a., nuk jane pranuar nga kjo e fundit. Per sa kohe qe nuk jane rakorduar te dhenat per sasine e energjise elektrike te levruar per mbulimin e humbjeve apo edhe per cmimin e shitjes se faturuar, mbetet i pasakte perditesimi i te ardhurave te teperta te KESH (KESH-GEN-FPSH) per efekt te shitjes se energjise elektrike ne treg.

- Grupi i Punes ka bere vlerësimet dhe analizat e treguesve teknik-ekonomik te vlefshem per perditsimin e tarifës se vitit 2012 te OST sh.a. Nga ana tjetër duke qene se kjo tarife ndikohet nga skenaret dhe percaktimet perkatese te sasise se energjise te transmetuar ne rrjetin e transmetimit, si pasoje e mos përcaktimit te sakte te sasise se energjise elektrike te levruar nga OSSH per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shpërndarjes, siuate kjo e krijuar nga boshllëku i krijuar nga OSSH gjate vitit 2012 dhe ne vijim te heqjes se licenses se aktivitetit te shperndarjes se energjise elektrike, eshte i pamundur vlerësimi i drejte ne kuader te te ardhurave te kerkuara dhe kostove reale.

Per sa i perket analizes se treguesve qe lidhen me ushtrimin e aktivitetit te shperndarjes dhe furnizimit publik me pakice eshte mjaft i veshtire cdo pozicionim mbi vleresimin e treguesve qe lidhen me percaktimin e humbjeve ne sistemin e shperndarjes pergjate vitit 2013-2014 dhe njohjes perkatese te ketyre kostove si te arsyeshme apo jo ne tarife, sa kohe qe humbjet reale ne rrjet jane rezultat i keqmenaxhimit te kompanise ne vitet e mepareshme, te cilat jane thelluar edhe me tej gjate vitit 2012. Nga ana tjetër vleresojme se per llogaritjen e humbjeve te energjise elektrike per efekt te tarifës eshte e veshtire te percaktohet targeti aktual dhe reduktimi per vitin pasardhes duke u nisur nga statusi aktual i shoqerise CEZ Shperndarje sh.a, e cila duke filluar nga data 21 janar 2013 eshte nen administrim te perkohshem per shkak te heqjes se licensave te shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakice, sipas Vendimive te Bordit te Komisionereve nr.4 dhe 5 date 21.janar 2013. Per me teper ne kushtet kur, sic permendet me siper jane hequr

licencat e shperndarjes dhe furnizimit publik me pakice, dhe nuk kemi ende nje operator zevendesues, detyrimet e Deklarates Rregullatore ne kete moment paqartesia te tregut energjetik do te mbeten ne fuqi dhe te pandryshueshme. Rikonsiderimi i ketyre treguesve dhe ecurise se tyre do te kerkonte me pare sqarimin e statusit te kompanise se shperndarjes ne kuader te perfundimit te procesit vijues pas heqjes se licencave i cili ka te beje me shpronësimin e asetëve sipas nenit 18 pika 5 e ligjit 9072 date 22.5.2003, “Per sektorin e energjise elektrike”, i ndryshuar.

Nje element i rendesishem i lidhur gjithashtu me te ardhurat e kerkuara, por edhe me nivelin e humbjeve ne sistemin e shperndarjes eshte realizimi i investimeve te miratuara per kete qellim. Investimet jane te lidhura nga ana tjetër me llogaritjet e kostove te borxhit si dhe me amortizimin dhe se fundmi me kthimin e lejuar mbi asetet. Gjate vitit 2012 ashtu sikurse eshte theksuar edhe ne vendime te meparshme te ERE-s (vendimi i heqjes se licencave) shoqeria e shperndarjes nuk i ka realizuar investimet e aprovuara ne tarifen e shperndarjes se energjise elektrike. Gjithashtu mbetet e veshtire te percaktojme se cfare do te behet me kete tregues (investimet) ne kushtet e statusit aktual te kompanise.

- Per sa i perket tarifës se Furnizimit Publik me Pakice, kjo tarife reflekton totalin e te ardhurave te kerkuara per cdo aktivitet te cituar me siper, tarifat e te cilave duhet te pranojne vetem shpenzimet e arsyeshme, sherbimet dhe asetet e siguruar ne menyre te kujdeshme dhe kostot e perfshira ne tarife do te ishin ato te realizuara nga nje operator i mire menaxhuar qe ben investime te kujdeshme, minimizon humbjet ne rrjet dhe shmang shpenzimet e panevojshme (ashtu sikurse percaktohet ne nenet 2.3 dhe 3.9 te metodologjive te tarifave te shperndarjes dhe furnizimit publik me pakice).

Ne perfundim duke konstatuar:

## **1. Paqartesi dhe pasiguri te treguesve kryesore te llogaritjes se tarifës se energjise elektrike per gjithe aktivitetet e rregulluara;**

- Paqartesia ne menyree e perllogratijes se treguesve, per efekt te llogaritjes se tarifave per aktivitetet e rregulluara, perfshire shitjen e energjise elektrike per vitin 2012 dhe parashikimin e shitjeve te energjise elektrike per konsumatorët tarifore per periudhen 2013-2014, nivelet e humbjeve te pranuar ne tarife si kosto te arsyeshme, si dhe investimet e lidhura me to, pamundesia per arritjen deri me tani te nje rakordimi per energjine e dhene me teper per mbulimin e humbjeve gjate viteve 2011 dhe 2012, per shkak te mosmarreveshjeve midis paleve.
- Ndryshimi i statusit te HEC Bistrica 1 dhe 2 dhe HEC Ulez Shkopet, per shkak te shitjes se aksioneve te ketyre kompanive tek investori privat, sipas akteve ligjore dhe nenligjore te cituara me siper, dhe te drejtes se ketij te fundit (investiorit) per te vendosur nese do te operoj me tej me KESH sh.a apo nese do te operoj ne treg te parregulluar (shitje te energjise elektrike tek Klientet e Kualifikuar dhe Tregtaret).

## **2. Status ne administrim te perkohshem te shoqerise CEZ Shperndarje;**

Ne kushtet e statusit juridik te kompanise CEZ Shperndarje, e cila eshte aktualisht nje shoqeri te ciles i jane hequr licencat dhe eshte nen administrim te perkohshem deri ne momentin e shpronësimit, krijon paqartesi ne menyren e llogaritjes se komponenteve qe lidhen me percaktimin e te ardhurave te kerkuara per kryerjen e aktiveteve te rregulluara te kesaj shoqerie. Kjo lidhet kryesisht me treguesit e performances se shoqerise, per te cilat ka pasur objektiva te vendosura ne kontraten e shitjes se aksioneve dhe te marra persiper nga investitori strategjik CEZ a.s.

**3.** Aktualisht ERE me vendimet e dates 7.12.2011 ka aprovuar nje tarife mesatare trevjecare per periudhen 2012-2014 per te gjithë operatorët, bazuar ne mesataren e te ardhurave te kerkuara per te treja vitet. Kjo i krijon te gjithë operatorëve te rregulluar ne tregun e energjise elektrike mundesine e operimit ne kushte normale per periudhen rregullatore 2012-2014 per te garantuar sigurine e furnizmit me energji elektrike. Gjithashtu nisur nga statusi aktual i shoqerise se shperndarjes, ERE do te mbikqyre destinacionin e shpenzimeve dhe te ardhurave te shoqerise sipas skedulimeve te miratuara



nga ERE. Miratimi i ketij skeduli dhe ndjekja e tij ne vazhdimesi ka stabilizuar gjendjen e likuiditeteve te operatoreve ne treg perfshire KESH sh.a, OST, Prodhuesit e Vegjel apo PPE, dhe ka bere te mundur krijimin e burimeve te brendeshme per shoqerine e shperndarjes ne kryerjen e nje aktiviteti normal.

4. Situata aktuale ne sektorin e energjise elektrike eshte e ngjashme per nga paqartesia e vendosjes se objektivave me situaten e vitit 2009, vit kur u mbyll procesi i privatizimit te 76% te aksioneve te kompanise se shperndarjes dhe ku ERE shtyu afatin e zbatimit te tarifave te vitit 2008 pergjate vitit 2009 (Vendimi nr.7 date 26 janar 2009).

**I Propozojme Bordit te Komisionereve lenien ne fuqi** deri ne daten 31 dhjetor 2013, te tarifave te miratuara perkatesisht me vendimet si me poshte :

- Vendimin nr. 144, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga KESH sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 87, date 29.06.2012 “Per rishikimin e tarifes per Furnizuesin Publik me Shumice per Periudhen e Trete Rregullatore per akomodimin e efekteve financiare te vendimit Nr.80 date 15.06.2012 te Bordit te Komisionereve te ERE-s”.
- Vendimin nr. 151, date 7.12.2011 Per percaktimin e cmimit te shitjes te energjise elektrike te prodhuar nga TEC Vlore sh.a. tek FPSH, per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 152, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga HEC Bistrice 1,2 sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 153, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga HEC Lanabregas sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 154, date 7.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga HEC Ulez Shkopet sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.
- Vendimin nr. 146, date 7.12.2012 te Bordit te Komisionereve “Per miratimin e tarifes se transmetimit te energjise elektrike nga OST sh.a. per Periudhen e Trete Rregullatore”.



- Vendimin Nr.147, date 07.12.2011 “Per percaktimin e tarifes se shperndarjes te energjise elektrike per periudhen e trete rregullatore 2012-2014 dhe Nr.148 date 07.12.2011 “Per percaktimin e cmimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per konsumatorët tarifore per periudhen e trete rregullatore”.
- Vendimi Nr.149 date 07.12.2012 “Per percaktimin e cmimit unik te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW per vitin 2012” .
- Vendimi Nr. 150 date 07.12.2012 “Per percaktimin e cmimit unik te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet egzistues me fuqi te instaluar deri ne 10 MW per vitin 2012”.

2- Perditesimin dhe kompesimin e te gjitha efekteve financiare ne vitin pasardhes brenda te njejtës periudhe rregullatore 2012-2014, periudhe e cila do te sherbeje per qartesimin e situates se tregut energjetik, statusit te shoqerise se shperndarjes, duke i krijuar keshtu mundesine rregullatorit per qartesimin, verifikimin dhe percaktimin sa me te drejte te treguesve, te ardhurave te kerkuara per aktivitetet e gjenerimit publik, furnizimit me shumice, transmetimit, shperndarjes se energjise elektrike dhe furnizimit me pakice te konsumatorët tarifore.